

**PLATFORMA**  
**PËR ZHVILLIMIN E UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI” KORÇË**  
**PËR PERIUDHËN 2020-2024**

**Kandidati për rektor: Prof Dr Lorenc Ekonomi**

**SË BASHKU PËR UNIVERSITETIN TONË**

Universiteti i Korçës është një nga institucionet arsimore më të rëndësishme të trevës së Korçës, një pasuri kombëtare që për vite me radhë ka mbledhur rreth vetes vlerat intelektuale më të mira të vendit tonë. Në të kanë studiuar breza me radhë nga i gjithë vendi, që sot japin kontributin e tyre në të gjitha fushat, brenda e jashtë vendit.

Por sot, për shkak të faktorëve të jashtëm, por edhe të brendshëm, ky universitet nuk po jeton ditët e tij më të mira. Po përmend disa fakte të thjeshtë: numri i studentëve në rënie, lidhjet jo në nivelin e duhur me komunitetin dhe institucionet lokale si dhe klasifikimi i dobët në renditjen boterore të universiteteve.

Për të gjitha këto arsye, me bindjen që ky universitet i ka të gjitha mundësitë intelektuale për tu kthyer në normalitet e ringritur, kam kandiduar për postin e Rektorit të Universitetit të Korçës në zgjedhjet për organe dhe poste drejtuese në universitet që zhvillohen në datën 30 korrik 2020.

Kam besim të patundur se ne i kemi të gjitha mundësitë për tu kthyer në ditët tona më të mira duke u bërë një institucion i besueshëm për të gjithë nxënësit e familjet korçare e më gjerë, si dhe për gjithë komunitetin.

**Hyrje**

Platforma që paraqes është produkt i një pune dhe dialogu të gjatë në vite me shumë faktorë dhe përbën një vizion konkret për të ardhmen e universitetit tonë. Kjo platformë shpreh aspiratën e çdo pedagogu, studenti apo punonjësi të administratës, çdo qytetari e komuniteti për një universitet modern, dinjitoz e bashkëkohor, në shërbim të së ardhmes të shoqërisë.

Kjo platformë merr në konsideratë dhe bazohet në përvojën pozitive drejtuese në vite të universitetit tonë, nxjerr mësim nga kjo përvojë dhe bën objektiv parësor përvojën perëndimore në drejtimin e funksionimit të universiteteve.

Ajo do të ketë synim përgatitjen e studentëve jo vetëm si ekspertë të fushave të ndryshme, por edhe si qytetarë të formuar me normat dhe standardet e demokracisë e të së drejtës, të përgjegjshëm për të nxitur zhvillimin e bashkëpunimin.

Nisur nga misioni i arsimit të lartë në vendin tonë, synimet tona do të orientohen tek përballimi i sfidave që shtrohen si:

-Konsolidimi i roli të sistemit universitar në plotësimin e nevojave të shoqërisë për kohën që jetojmë;

-Krijimi, transmetimi, zhvillimi dhe mbrojtja e ideve të brezit të ri me anë të mësimdhënies e kërkimit shkencor;

-Krijimi i një terreni praktik për aplikimin e filozofisë së një formimi profesional e civil sa më të larmishëm;

-Krijimi i mentalitetit tek studentët, për të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke u ofruar një mjedis pedagogjik e shkencor sa më cilësor e fleksibël;

-Sigurimi i kontributit të këtij brezi në zhvillimin e përparimin e vendit në nivel lokal e kombëtar.

Në këtë kuadër, universiteti do të kthehet në një qendër integrale me kontribut të rëndësishëm në të gjitha nivelet dhe drejtimet e rajonit tonë të aftë për të ndjekur e paraprirë dinamikën e zhvillimeve ekonomike e shoqërore, logjikën dialektike të kërkesës dhe ofertës sipas procesit të Bolonjës, nga këndvështrimi i mobiliteteve, niveli i atraksionit të universiteteve dhe shkalla e krahasimit me universitetet analoge brenda e jashtë vendit.

Të gjitha këto objektiva do të realizohen duke u ngritur kundër çdo imponimi të vullnetit të autoritetit drejtues në çdo nivel, konsultimit dhe përfshirjes në vendimarrje të të gjithë personelit akademik dhe studentëve, duke siguruar barazinë dhe pavarësinë akademike, duke respektuar ligjin dhe aktet e tjera normative, duke mbrojtur dinjitetin e integritetin e personelit akademik, administrativ e të studentëve, duke ndihmuar në kualifikimin profesional e akademik të tyre, duke krijuar infrastrukturën dhe lehtësirat e duhura për pjesëmarrjen në veprimtari akademike e shkencore brenda e jashtë vendit, duke rritur e duke kthyer universitetin në faktor të rëndësishëm të mendimit më të përparuar akademik, shkencor e kulturor.

## **1. NË DREJTIM TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE DHE TË KËRKIMIT SHKENCOR**

a) Për të patur efikasitet në këto veprimtari do ti jepet përparësi forcimit të rolit të departamenteve. Organizimi i brendshëm i punës në department do të bëhet në funksion të formimit akademik dhe kërkimit. Deri tani departamentet janë

organizuar dhe funksionojnë vetëm si njësi akademike, në funksion të mësimdhënies dhe jo të kërkimit. Në departamente do të nxitim dhe mbështetim organizimin dhe funksionimin e grupeve të kërkimit rezultatet e punës me projektet e kërkim-zhvillimit rajonal e kombëtar.

Departamentet do të jenë përgjegjëset kryesore për programet e studimit që ofrojnë. Departamentet do të jenë qelizat bazë që do të nxitin, zhvillojnë, organizojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Departamentet do të ofrojnë shërbime për të tretë dhe veprimtari të tjera. Ata do të manaxhojnë fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera. Në kuadrin e shërbimeve ndaj të tretëve do të nxitin departamentet që të aplikojnë për marrje licensash, si ajo për edukimin në vazhdimësi të mësuesve dhe specialistëve, laboratorë të akredituar, ekspertiza, mbrojtje të mjedisit apo veprimtari të tjera. Kështu të gjitha të ardhurat e departamentit do të përdoren prej tij për shpërblimin e anëtarëve të tij, për përmirësimin e infrastrukturës dhe një pjesë do të shkojë në të ardhurat e universitetit.

Do të nxitet, përkrahet e respektohet çdo inisiativë personale e pedagogëve apo e departamenteve që përfshin sa më shumë pedagogë, studentë e faktorë të interesit.

b) Do të synohet me çdo kusht zgjerimi dhe konsolidimi i ciklit të tretë të studimeve. Do të punohet në bashkëpunim me të gjithë faktorët për hapjen e masterave ekzekutive dhe të doktoraturave, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, të Kamzës, Politeknik apo dhe të tjerë brenda dhe jashtë vendit në fushat e Bujqësisë, Mësimdhënies dhe Ekonomisë.

c) Një çështje e veçantë do të jetë dhe dokumentacioni i pedagogëve në problemet e mësimdhënies. Do të zhvillohet një diskutim i gjerë në lidhje me dokumentacionin e pedagogut. Regjistri i pedagogut ka krijuar një ngarkesë artificiale për pedagogët, përvojë në mjaft situata ai nuk është efikas. Kjo merr shkas edhe nga futja e gjithnjë e më shumë e programeve kompjuterike.

d) Ka vend për të përmirësuar e konsoliduar thelbin e cilësisë së mësimdhënies. Departamentet do të organizojnë me përgjegjësi orë mësimi në të cilat anëtarët e departamentit të marrin eksperiencë nga koleget e tyre bazuar në një debat konstruktiv.

e) Përparësi do të ketë përdorimi i literaturës bashkëkohore dhe atë më cilësore në punën mësimore dhe kërkimore-shkencore nga pedagogët dhe studentët. Për këtë do të bëhet abonimi në libraritë elektronike më të mira. Me literaturën e marrë prej tyre do të bëhet pasurimi i bibliotekave të fakulteteve dhe atyre personale të pedagogëve e studentëve.

ë) Buletini Shkencor apo ato të fakulteteve do të kthehen një diskutimi të gjerë. Buletini apo ato ekzistuese kanë devijuar nga rregullat që përcakton rregulli i marrjes së ISSN. Fakultetet do të vendosin ne se duan të kenë buletinin e tyre me ISSN e re ose do të përdorin Buletinin Shkencor. Botimet do të jenë on line ose hard copy, në gjuhën angleze, disa herë në vit, me një pagesë të caktuar nga autorët, me të cilat do të paguhen punonjësit e montimit të revistës, redaktorët dhe recezentët.

f) Një vëmendje të veçantë do të ketë pjesëmarrja në projekte nga pedagogët dhe studentët e universitetit tonë. Do të mbështetet fuqimisht çdo projekt i iniciuar nga departamentet apo pedagogë të veçantë që do të përfshijnë sa më shumë pedagogë dhe studentë. Do të garantohet një transparencë maksimale në aplikimet që do të bëhen si dhe në shpenzimet e projekteve dhe personat që do të marrin pjesë. Zyra e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor do të fuqizohet dhe do të informojë, do të nxitë, do të kryejë asistencë teknike për plotësimin e aplikimeve nga ana gjuhësore, formale, shkencore e ekonomike dhe do të mbajë përgjegjësi për numrin dhe cilësinë e aplikimeve. Do të mbështeten projektet që do sigurojnë jo vetëm të ardhurat e tyre, por ata që pas përfundimit të tyre sigurojnë të ardhura të tjera. Interes do të kenë projektet e realizuara në bashkëpunim me universitete të tjera brenda e jashtë vendit në kuadrin e projekteve të Bashkimit Evropian. Do të synohet që në fund të realizimit të projekteve studimore apo dhe të tjera të ketë botime cilësore të arritjeve. Do të punohet që pedagogët, fakultetet apo dhe Zyra e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor të forcojnë lidhjet homologe me kolegët e tyre brenda e jashtë vendit. Kjo do rritë bashkëpunimin dhe partneritetin me ta sa herë të jetë nevoja dhe interesi i përbashkët duke na ofruar projekte cilësore.

g) Do të mbështeten botimet e pedagogëve në revista shkencore të botuara në vendet e BE. Për artikujt e botuar në revista me factor impakti ISI Thomson Reuters ose SCOPUS do të krijohet një skedar dhe autorët do të jenë shembull i pararojës në botimet e pedagogeve. Për çdo punim do të jepet një shpërblim fiks. Do të mbështeten pjesëmarrjet në konferenca ndërkombëtare nga pedagogët e studentët. Në se këto konferenca do të zhvillohen në vende të BE, universiteti do të marrë përsipër të paguajë një kuote fikse të shpenzimeve.

h) Një drejtim i rëndësishëm do të jetë organizimi i konferencave ndërkombëtare e kombëtare. Mbështetja financiare nuk do të mungojë sidomos për fushat me interes si: mësimdhënia, ekonomia, bujqësia, shëndeti publik etj.

i) Një detyrë imediate dhe që kërkon zgjidhje të shpejtë është regjistrimi i të gjithë pedagogeve të rinj në doktratura. Do të bëhet çdo gjë që është e mundur duke bashkëpunuar me çdo faktor të mundshëm për t'ia arritur kësaj sfide.

j) Një vëmendje të veçantë do ti kushtohet ngritjes së strukturave njerëzore dhe infrastrukturave lobuese brenda dhe jashtë universitetit, për sigurimin e prurjeve më të mëdha të studentëve. Do të synohet të krijohen lidhje dhe komunikim i vazhdueshëm dhe i ngushtë me gjithë faktoret politikë, ekonomikë dhe shoqërorë të rajonit dhe në qendër si: bashkitë, deputetët, ministrat, Qarku, Prefektura, Drejtoritë Arsimore dhe personalitete të tjera dashamirëse duke institucionalizuar takimet me ta, të cilat do të ndihmojnë në rritjen e mbështetjes ndaj universitetit në çdo aspekt.

k) Do të kihet në konsideratë programet e ekselencës. Do të pasurohen dhe rifreskohen në mënyrë periodike modulet që do të zhvillohen dhe do të përmirësohet politika e çmimeve të krediteve si dhe e shpërblimeve për pedagogët.

l) Do të tregohet vlerësim për personelin akademik që del në pension, sidomos për ata me titullin “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”, të cilët do të vazhdojnë të jenë aktivë në universitet edhe pas daljes në pension. Kjo do të ketë si qëllim nga njëra anë përfitimin direkt të kontributit të tyre në procesin mësimor dhe nga ana tjetër përgatitjen dhe dhënien e eksperiencës së tyre të vyer pedagogëve më të rinj.

## **2. NË DREJTIM TË RRRITJES SË PERFORMANCËS SË UNIVERSITETIT**

a) Përmirësimi dhe përditësimi cilësor i faqes web zyrtare të internetit, e cila do të jetë aktive dhe në dispozicion të çdo departamenti, fakulteti e strukture tjetër. Cdo informacion në faqen zyrtare do të jepet në dy gjuhe: shqip dhe anglisht. Kjo faqe do të pasurohet me një sërë rubrikash të tjera të dobishme për studentët, pedagogët e të interesuarit.

b) Rregulloret e studimeve për çdo degë do të jenë të afishuara dhe të organizuara në guida vjetore dhe të afishuara në Internet.

c) Publikimi dhe reklamimi periodik i aktivitetit kërkimor-shkencor dhe arritjeve të personelit akademik në formën e botimeve elektronike dhe shpërndarja e promovimi i tyre në organizma akademike, publike e private brenda dhe jashtë vendit.

e) Vazhdimi i traditës së viteve të kaluara të dhënies së diplomave studentëve me ceremonitë përkatëse si një detyrim ndaj punës dhe arritjeve të studentëve dhe pedagogëve.

f) Thellimi i punës për arritjen e standardeve të cilësisë nëpërmjet:

- Evidentimit të mangësive, diagnostikimi i problemeve në përparimin akademik të studentëve të rinj;

- Evitimit të përvojave të vjetëruara shkollareske të asimilimit mekanik të njohurive, të mendimit të “ngrirë” e pa përmbajtje, të varfër e pa ide, dogmatik dhe të “parafabrikuar”;
- Nxitjes së mendimit të gjallë, reflektiv, krijues e kritik si *standardi i pare* i procesit universitar;
- Rritjes së nivelit të ekspertizës profesionale në didaktikën e shkencave për të reformuar punën tonë me studentët;
- Rolit të Qendrave së Ekselencës në funksion të procesit të të nxënit;
- Nxitjes së rritjes së mëtejshme të kërkesës për studime në Universitetin e Korçës duke i lidhur më mirë programet e studimit me tregun e punës dhe zhvillimin rajonal;
- Inspirimit të një pedagogjie produktive, veçanërisht didaktikës së shkencave, për të mbështetur intelektualisht studentët, duke respektuar diferencat midis tyre;
- Promovimit të programeve të studimit të mirëstrukturuar, procedura efiçente dhe të qendrueshme duke reflektuar një mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive si dhe vlerësim inovativ dhe fleksibël;
- Testimit transparent dhe të vazhdueshëm të cilësisë së brendshme të fakultetit për të rritur besueshmërinë dhe sigurimin e rezultateve domethënëse;
- Inkurajimit të departamenteve për të reformuar kurrikulatteorike dhe praktike, të orientuara nga zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe që promovojnë etikën profesionale.

#### g) Rritja e reputacionit dhe produktivitetit të kërkimit

- Përqendrimi i ekspertizës së stafit në mënyrë që të konsolidohen anët e forta ekzistuese dhe ato potenciale të kërkimit;
- Kooperimi dhe mbështetja për kërkuesit e rinj brenda grupeve për t'i ndihmuar ata në projektet e tyre kërkimore dhe publikimin e rezultateve;
- Fokusimin më tepër në programet e kërkim-zhvillimit që mbështeten nga Fondi Kombëtar për Kërkimin Shkencor dhe të BE-së;
- Sigurimin e një strukture për komunikimin e rezultateve të kërkimit tek studentët, nxitjen e kërkimit tek studentët nëpërmjet trajnimit të tyre;
- Promovimit të rezultateve kërkimore brenda dhe jashtë universitetit.

### **3.PËRPUNIMI I NJË PLATFORME EFIKASE TË NJËSIVE PËR ARRITJEN E STANDARTEVE TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT**

- Duhet vazhduar puna në drejtim të përmirësimit të kurrikulave, duke i lidhur ato më tepër me tregun e punës dhe zhvillimin rajonal;
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies duke shfrytëzuar më mire bazën didaktike dhe metodat interaktive të mësimi;
- Përdorimi më eficient i bazës laboratorike, si pika të forta të disa fakulteteve në këtë universitet në formimin akademik të studentëve si dhe të veprimtarisë kërkimore;
- Rritja e mëtejshme e produktivitetit të metodave të të nxëniet dhe zhvillimi më i mirë i praktikave profesionale;
- Zhvillimi cilësor i metodave të kontrollit dhe vlerësimit të njohurive duke nxitur format e ballafaqimit me studentin në provime;
- Përmirësimi i raportit pedagog/student dhe njëkohësisht raporti midis pedagogëve të jashtëm dhe atyre të brendshëm në favor të këtyre të fundit në disa fakultete;
- Zhvillimi i infrastrukturës, bibliotekës dhe mjediseve për të mbështetur më mirë procesin akademik si dhe për të gjallëruar jetën studentore;
- Zgjerimi i pjesëmarrjes së personelit akademik në projektet e kërkimit që ofrojnë Programet Kombëtare dhe ato Ndërkombëtare duke nxitur trajnimin dhe ngritur nivelin e ekspertizës së aplikimeve;
- Thellimi i mëtejshëm i punës organizative të departamenteve mbi bazën e kërkesave që ka aktiviteti kërkimor. Ngritja dhe mirëfunksionimi i grupeve mësimore-kërkimore dhe konsolidimi i Qendrave të Ekselencës në fakultete;
- Thellimi i mëtejshëm i punës kërkimore me studentëtnëpërmjet komunikimit të rezultateve të kërkimeve në fakultet si dhe trajnimit të tyre me konceptet dhe parimet e etikës në kërkim;
- Intensifikimi i punës kualifikuese të personelit nëpërmjet projekteve të kërkimeve doktorale, botimeve të artikujve shkencore, në organe me autoritet shkencor, pjesëmarrjes në konferenca shkencore ndërkombetare e rajonale;
- Përkrahja e nismave të departamenteve për organizimin dhe zhvillimin në fakultete të aktiviteteve shkencore;

- Mbështetja e kërkuesve të rinj në fakultet e universitet duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat ligjore dhe kapacitetet e brendshme akademike për t'i atashuarata në programet kërkimore të departamenteve.

#### **4. NË DREJTIMIN FINANCIAR**

a) Synimi bazë do të mbetet shtimi i të ardhurave nga burime që nuk lidhen me transfertat nga Buxheti i Shtetit si:

- Të ardhura të realizuara nga kryerja e punimeve shkencore dhe projekte kombëtare e ndërkombëtare;

- Të ardhura të realizuara nga organizimi i trajnimeve për të tretët;

- Të ardhura nga punime shkencore për të tretët, nga ofrime shërbimesh për të tretët, ekspertiza, analiza laboratorike, etj.

b) Synim tjetër është rritja në buxhetin e universitetit të financimeve në drejtim të veprimtarisë akademike e shkencore. Financimet në këtë drejtim do të bëhen në bazë të kriterit të meritës personale ose në grup, duke institucionalizuar një sistem objektiv dhe të saktësuar vlerësimi. Rëndësi do të marrë gjithashtu sipas mundësive, zëri i financimeve për efekte të komunitetit të universitetit dhe ai për shpërblime për të gjitha kategoritë e punonjësve në universitete. Për të gjitha këto do të ketë kritere unike.

c) Në administrimin financiar do të aplikohen skema që sigurojnë transparencë, drejtësi, stimulimin e aftësive personale kërkimore shkencore si dhe për arsye humane. Parimi do të jetë: Gjithkush katë drejtë të kontrollojë dhe të marrë pjesë në hartimin dhe administrimin e buxhetit të universitetit.

d) Do të synohet sigurimi i fondit financiar për ndërtimin e dy godinave të reja apo ristrukturimin e godinave që do të na jepen, me qëllim zgjerimin e kapaciteteve mësimdhënëse, sidomos tani në kushtet e zvogëlimit të tyre pas marrjes së godinës së ish-Shtëpisë së Ushtarakëve.

#### **5. STUDENTËT**

Duke qenë se përbëjnë objektin kryesor të misionit të universitetit, studentët do të trajtohen si subjekte efektive dhe aktive në realizimin e këtij misioni. Atyre do t'u ofrohet një mjedis pedagogjik e shkencor sa më cilësor e fleksibël duke synuar rritjen e interesit të tyre ndaj auditorëve.

Do të rritet kontakti direkt me ta për të tërhequr sa më mirë dhe më shpejt mendimet dhe vlerësimet e tyre, të cilat do të përmirësojnë aktivitetin e institucionit.

Studentëve do tu krijohen kushte dhe mundësi për një jetë sa më aktive dhe më të kulturuar në favor të vetes e të komunitetit, kushte për të përfituar sa

më efektivisht dije dhe kualifikim shkencor si dhe për t'u integruar me jetën akademike ndërkombëtare.

Një rëndësi e veçantë do ti kushtohet nxitjes, intensifikimit, organizimit dhe mbështetjes me të gjitha mënyrat të aktiviteteve sportive dhe kulturore me studentët, që do të ndihmojë në edukimin e tyre shpirtëror dhe shoqëror krahas atij mësimor-shkencor, duke e bërë më tërheqëse periudhën e tyre të studimit akademik. Organizimet e tyre jo vetëm do të jenë të lira, por edhe do të stimulohen e do t'u krijojnë të gjitha predispozitat për të qenë faktor në vendimarrje.

Për studentët do të ketë anketime të vazhdueshme që në momentin e fillimit të studimeve e deri në diplomimin e tyre, ku do të pyeten për arsyet e ardhjes në universitet, për probleme të mundshme që ata do të kenë gjatë periudhës së studimit të tyre. Do të krijohet një database për të diplomuarit (ALUMNI) në të gjitha degët, do të ndiqet punësimi i tyre dhe do të kryhen anketime me ta për të analizuar nga një këndvështrim tjetër problemet e studentëve. Të gjitha problemet që do të dalin do të shërbejnë për përmirësimin e rregulloreve apo dhe të punës së pedagogëve.

Universiteti do të krijojë infrastrukturën e përshtatshme për studentë, të cilët do ta përdorin atë për procesin mësimor dhe procesin studimor dhe të kërkimit. Ata do të përfitojnë nga shërbimet që ofrohen nga institucioni. Studentët do të sigurohen nga institucioni në shoqëri të sigurimeve për kohën e studimeve. Studentët do të krijojnë këshillat e tyre studentore, të cilat do të respektohen e dëgjohen me vëmendje për problemet e tyre, të cilave do tu jepet zgjidhje. Ato do të japin mendime dhe propozime për të gjitha problemet që lidhen me zhvillimin e mësimin, rregulloret e studimeve, shërbimet që kryhen kundrejt studentëve si dhe transparencën e vendimarrjeve.

Studentët do të pajisen me kartën e studentit, me ndihmën e së cilës ata do të marrin shërbime me çmime të reduktuara.

Për studentët me mangësi në njohuritë e tyre, sidomos atë vitit të parë, departamentet do të organizojnë kurse konsultimesh.

Do ti kushtohet një rëndësi e madhe punësimit të studentëve me të ardhura minimale për shërbime brenda Universitetit dhe më gjerë.

Studentëve me mesatare mbi 9 do tu jepet bursë. Për studentët në degë të veçanta, një pjesë të shpenzimeve t'i përballojë universiteti, si mund të jenë akomodimi falas në qendrën studentore, tekstet mësimore etj.

**Të nderuar kolegë,**

**Ky është në vija të përgjithshme projekti i ofruar prej meje për zhvillimin e universitetit tonë për këtë mandat të ri. Ne i kemi të gjitha kapacitetet, energjitë, vullnetin, dijet, aftësitë dhe dëshirën e mirë për ta bërë realitet atë. Mbështetja juaj është garancia finale për realizimin e tij. Ju do të jeni frymëzuesit e mëtejshëm dhe realizuesit e këtij projekti. Universiteti dhe komuniteti do të jenë përfituesit e tij.**

**Le të punojmë së bashku për të ngritur universitetin tonë në një nivel më të lartë, bashkëkohor dhe rezultativ dhe ti japim atij emrin dhe rolin që meriton.**

**Me respekt**

**Prof. Dr. Lorenc Ekonomi**